

## **Vendim nr. 177, datë 29.05.2026**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese  
Ilir Toska, Anëtar  
Genti Ibrahimi, Anëtar

në datën 29.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (D) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** DRITA MARKU

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-2513 (277), datë 25.06.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 4, 17, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I**

1. Kërkesja Drita Marku ka punuar pranë Forcave të Armatosura (*FA*), fillimisht si laborante e matematikës në repartin ushtarak nr. 5560, më pas si laborante specialiste, pedagoge dhe instruktore. Me urdhrin nr. 3185, datë 08.08.2012 të komandantit të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes (*KDS*), kërkesja është emëruar pedagoge e informatikës në

Akademine e Nenoficerëve. Për këtë, në datën 20.12.2012, mes kërkueses dhe KDS-së është lidhur kontrata individuale e punës (*kontrata e punës*), me afat të pacaktuar, e cila ka hyrë në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i ka shtrirë efektet nga data 01.10.2012.

2. Kërkuesja ka ushtruar detyrën e pedagoges në Akademine e Nenoficerëve deri në datën 30.09.2014, kur marrëdhënia e punës është ndërprerë nga KDS-ja. Kështu, në kuadër të ndryshimeve strukturore të KDS-së dhe reparteve në varësi të saj si pasojë e kalimit në strukturë të re organizative të FA-së, me shkresën nr. 2471/1 prot., datë 03.07.2014, KDS-ja ka njoftuar kërkuesen për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare për shkak të pamundësisë së sistemimit në punë sipas strukturës së re. Në vijim, me urdhrin nr. 3101/3 prot., datë 08.09.2014 (*urdhri nr. 3101/3/2014*) të zëvendëskomandantit të KDS-së është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe asaj financiare në datën 30.09.2014 për disa punonjës të personelit civil të Akademisë së Nenoficerëve, përfshirë edhe kërkuesen. Ky urdhër është ndryshuar me urdhrin nr. 4266/1 prot., datë 27.11.2014 të KDS-së, duke u shtuar pas pikës 6, pika 1/1, sipas së cilës kërkueses i paguhej leja vjetore e pakryer e vitit 2014, si dhe shpërblimi për vjetërsinë në punë në pagën e një 15-ditëshi për çdo vit të plotë pune, sipas përcaktimeve të nenit 145, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Punës (*KP*). Më pas, me urdhrin nr. 1330/2 prot., datë 04.12.2014 të KDS-së, është urdhëruar që kërkuesja të paguhej për 21 ditë leje të pakryer për vitin 2014, si dhe me 4,5 paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë.

3. Në datën 28.10.2014 kërkuesja i është drejtuar me ankim administrativ ministrit të Mbrojtjes, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit për largimin e saj nga puna, kthimin e saj në punë me statusin e nëpunëses civile dhe pagimin e pagës për periudhën e qëndrimit pa punë, por nuk ka marrë përgjigje. Më pas, në datën 03.11.2014, kërkuesja i është drejtuar KDS-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes me kërkesë për informacion për procesin administrativ për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, kurse në datën 11.11.2014 ka kërkuar informacion nga Departamenti i Administratës Publike (*DAP*) në lidhje me procedurën administrative për përfitimin dhe njohjen *ipso lege* të statusit të nëpunëses civile.

4. Me shkresën e datës 14.11.2014, Ministria e Mbrojtjes ka sqaruar kërkuesen se *“për punonjësit civilë të FA-së, pozicionet e punës së tyre nuk janë përfshirë ende në deklarin e statusit të punësimit që duhet të bëjë DAP-i. Duke qenë se marrëdhëniet tuaja të punës rregullohen me KP-në, për arsyet e sipërpërmendura, ju nuk e gëzoni statusin e nëpunësit civil, ndaj për këtë rast procedurat e ndjekura nga KDS-ja janë kryer sipas KP-së”*. Kurse me shkresën e datës 05.01.2015 DAP-i i ka bërë me dije kërkueses se nuk ka zhvilluar asnjë procedurë administrative për përfitimin dhe njohjen *ipso lege* të statusit të nëpunëses civile për të.

5. Në datën 14.11.2014 kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi, kundërdrejtuar Ministrisë së Mbrojtjes, KDS-së dhe DAP-it, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe të paligjshmërisë së akteve dhe të veprimit administrativ të të paditurve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në datën 30.09.2014, detyrimin e të paditurve për t'i njohur e akorduar statusin e nëpunëses civile për shkak të ligjit nr. 152/2013, kthimin në detyrën e mëparshme dhe pagimin e pagës nga data 01.10.2014 e në vijim.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2213, datë 27.04.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadsisë, si të pabazuar në ligj dhe në prova, duke arsyetuar, në thelb, se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e marrëdhënies së punës në rastin konkret nuk ishte ligji nr. 152/2013 "Për statusin e nëpunësit civil" (*ligji nr. 152/2013*), por Kodi i Punës (*KP*), pasi kërkuesja, gjatë vijimit të marrëdhënies së punës, nuk rezultonte të kishte fituar statusin e nëpunëses civile. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, kërkimet e padsisë, të mbështetura mbi këtë shkak ligjor, ishin të pabazuara në ligj.

7. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 2036, datë 17.05.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke urdhëruar detyrimin e të paditurave, Ministrisë së Mbrojtjes dhe KDS-së, që t'i paguajnë kërkueses dëmshpërblimin me pagën e 12 muajve, për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës dhe me pagën e 2 muajve, për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, si dhe t'i paguajnë pagën për periudhën 30.09.2014-03.10.2014, për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se vendimi i gjykatës administrative të shkallës së parë, në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material, që gjente zbatim në rastin konkret, duhej ndryshuar për sa i përkiste mënyrës së rivendosjes të të drejtave të paditëses (kërkueses) në përputhje me dispozitat e KP-së dhe jo të ligjit nr. 152/2013, sikundër kërkuesja pretendonte. Në këtë drejtim, edhe gjykata e apelit ka vlerësuar se nuk rezultonte që kërkuesja të kishte fituar statusin e nëpunëses civile sipas ligjit. Nga ana tjetër, për sa i përket ndërprerjes së marrëdhënies së punës në rastin konkret, gjykata e apelit ka vlerësuar se ajo ishte realizuar pa u respektuar afati i njoftimit sipas nenit 143 të KP-së, pa u respektuar procedura sipas nenit 144 të KP-së, si dhe pa një shkak të justifikuar, ku mbi këtë bazë i ka akorduar kërkueses dëmshpërblimet përkatëse sipas këtyre dispozitave ligjore. Kundër vendimit kanë paraqitur rekurs kërkuesja dhe të paditurat, Akademia e FA-së (ish-KSD-ja) dhe Ministria e Mbrojtjes.

8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2513 (277), datë 25.06.2025, ka prishur vendimin e gjykatës së apelit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ai kolegji ka vlerësuar se të dyja gjykatat e faktit me të drejtë kanë pranuar se marrëdhënia e punësimit e kërkueses nuk është marrëdhënie administrative e shërbimit civil

dhe se ajo nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013. Nisur nga kjo, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se gjykata administrative e shkallës së parë ka përcaktuar drejt marrëdhënien juridike në konflikt, ligjin e zbatueshëm dhe, duke mbajtur në konsideratë kërkimet e padisë, shkakun dhe objektin e përcaktuar sipas ligjit nr. 152/2013, në përputhje me parimin e disponibilitetit të padisë, ka zgjidhur drejt çështjen, duke vendosur rrëzimin e padisë, pasi kërkimet e kërkueses nuk gëzonin mbrojtje ligjore. Nga ana tjetër, Kolegji Administrativ ka vlerësuar se Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka kualifikuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes, referuar natyrës së kërkimeve dhe arsyes së identifikuar nga kërkuesja, duke e zgjidhur gabim atë, për sa kohë ajo, për të cilën Gjykata Administrative e Apelit ishte shprehur, nuk përputhej me atë që kërkuesja i kishte kërkuar gjykatës me padinë e saj, duke vepruar kështu në shkelje të parimit *ultra petita partium*, pa pasur autorizim të shprehur ligjor.

9. Në datën 05.03.2026 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 17.03.2026.

## II

### Pretendimet e kërkueses

10. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

10.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka vendosur në kundërshtim me ligjin, duke devijuar nga thelbi i kërimit të vërtetë të kërkueses. Ajo gjykatë nuk ka kryer detyrën e saj, që është shqyrtimi i çështjes sipas ligjit për nëpunësin civil dhe legjislacionin tjetër dytësor të lidhur me të, duke devijuar shqyrtimin e mosmarrëveshjes nga thelbi i saj dhe duke dhënë një vendim haptazi të pabazuar. Gjykata e Lartë nuk ka vepruar dhe vendosur sipas përcaktimeve ligjore, por në mënyrë arbitrare.

10.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar me hollësi dhe nuk ka argumentuar se përse nuk i ka marrë parasysh pretendimet e kërkueses dhe efektet e ligjit për nëpunësin civil në rastin e saj. Ajo nuk ka argumentuar se përse ka lejuar dy praktika të kundërta për të njëjtën çështje dhe as nuk referon ndonjë dispozitë ligjore ku mbështet

vendimmartjen për rrëzimin e padisë. Gjykata e Lartë ka përcaktuar faktet dhe ka interpretuar ligjin e zbatueshëm në mënyrë arbitrare.

10.1.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 kërkuësja ka fituar *ipso lege* statusin e nëpunëses civile si punonjëse civile e FA-ve dhe lirimi nga detyra i ka mohuar një të drejtë të fituar me ligj. Urdhri për lirimin nga detyra është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, pasi KDS-ja e kishte të ndaluar shprehimisht lirimin nga detyra të personelit civil që ishte *ipso lege* subjekt i ligjit për nëpunësin civil. Marrëdhënia e punës së kërkuësës vijonte pa ndërprerje, ndaj gjykatat në mënyrë arbitrare nuk kanë respektuar ligjin nr. 152/2013, duke i shkelur të drejtat. Në lidhje me trajtimin financiar, ajo duhet të përfitonte pagën nga data e lirimit nga detyra deri në datën e rikthimit në të njëjtin pozicion ose në një pozicion të ngjashëm. Gjykata e Lartë nuk përmbushi detyrën për interpretimin e drejtë të ligjit, por u bë vetë burim pasigurie ligjore. Në një sërë vendimesh DAP-i, në zbatim të ligjit për nëpunësin civil, u ka njohur nëpunësve ekzistues statusin e nëpunësit civil, sikurse edhe Gjykata e Lartë në një rast i ngjashëm, ndërkohë që në rastin e kërkuësës ajo ka zhvilluar një jurisprudencë me efekt të kundërt, duke e përjashtuar kërkuësen nga pritshmëritë e ligjshme për fitimin e statusit të nëpunëses civile sipas ligjit.

10.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, i garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi pavarësisht se kërkuësja paraqiti një rast të ngjashëm ku gjykatat, përfshirë Gjykatën e Lartë, kishin mbajtur qëndrim të ndryshëm, ato nuk e morën parasysh. Gjykatat duhet t'i ishin referuar vendimit nr. 00-2018-155, datë 16.01.2018 të Gjykatës së Lartë, pasi edhe paditësi në atë rast kishte punuar pranë së njëjtte strukturë me kërkuësen dhe, pas daljes së ligjit për nëpunësin civil, atij i ishte njohur nga DAP-i statusi i nëpunësit civil, i cili më vonë iu revokua nga punëdhënësi, çka u konsiderua e paligjshme nga gjykatat, të cilat urdhëruan rikthimin e tij në shërbimin civil.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuësës

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore për shqyrtimin paraprak të kërkesës.

12. Kriteret paraprake të legjitimitimit janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë kriterëve të legjitimitimit, në varësi të elementeve dhe veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë dhe shterues për kërkuuesin. Thënë ndryshe, në shqyrtimin paraprak të një çështjeje mund të verifikohet mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, duke sjellë si pasojë moskalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare. Mbi këtë bazë, Kolegji, në vijim, do të ndalet në kriterin e legjitimitimit *ratione materiae*.

13. Në drejtim të kriterit *ratione materiae*, i cili vlerësohet në raport me pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues, rezulton se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës për kundërshtimin e procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* dhe të *parimit të barazisë përpara ligjit*. Për sa i përket pretendimeve në drejtim të së drejtës për proces të rregullt, sipas kërkuëses është cenuar e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor dhe parimi i sigurisë juridike. Megjithatë, referuar natyrës së këtyre pretendimeve dhe argumenteve, në bazë të të cilave janë mbështetur ato, rezulton se në thelb ato kanë të bëjnë me standardin e arsytimit të lidhur me mënyrën sesi gjykatat kanë interpretuar dhe zbatuar ligjin për zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete në shqyrtim.

14. Gjykata në jurisprudencën e saj ka ritheksuar vazhdimisht qëndrimin e konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe zbatimi i ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e saj është të verifikojë nëse procesi në tërësinë e tij ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës*

*Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 4, datë 31.01.2024; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe t'u japë mundësinë ta kundërshtojnë atë. Gjykata e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve kushtetuese, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet mbi të cilat është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 17, datë 23.03.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 18, datë 30.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mund të vihen në dyshim nga Gjykata vetëm kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, ajo vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën gjykimin të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kolegji, referuar akteve bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, konstaton se kërkuesja i është drejtuar gjykatës me padi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe të paligjshmërisë së akteve dhe veprimit administrativ të të paditurve, konkretisht të urdhrin nr. 3103/3/2014 të zëvendëskomandantit të KDS-së për lirim të saj nga detyra e pedagoges së informatikës, si dhe detyrimin e të paditurve për kthimin në detyrën e mëparshme dhe pagimin e pagës nga data 01.10.2014 e në vijim. Kërkuesja ka pretenduar se marrëdhënia e punës nuk mund të zgjidhej në bazë të KP-së, pasi ajo mbrohej nga legjislacioni për nëpunësin civil, për sa kohë që e kishte fituar këtë status *ipso lege* sipas nenit 67 të ligjit nr. 152/2013.

17. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka rrëzuar padinë e kërkueses, duke e gjetur të pabazuar në ligj. Ajo ka arsyetuar se marrëdhënia e punës së kërkueses me të paditurën, KDS-në, rregullohej sipas dispozitave të KP-së, pasi mes tyre ishte lidhur kontrata individuale e punës e datës 20.12.2012, me afat të pacaktuar, me nënshkrimin e së cilës palët kishin përcaktuar si ligj të zbatueshëm KP-në. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, nuk qëndronin pretendimet e kërkueses se në rastin e saj ishte i zbatueshëm ligji nr. 152/2013, pasi ajo nuk e kishte gëzuar statusin e nëpunësit civil përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Po sipas asaj gjykate,

FA-ja nuk është pjesë e administratës shtetërore dhe, referuar përmbajtjes së nenit 2, shkronja “dh”, të këtij ligji, për të nuk ishin të zbatueshme dispozitat e ligjit nr. 152/2013, të cilat zbatohen për çdo nëpunës civil që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore me përjashtim të ushtarakut të FA-së. Po kështu, gjykata ka vërejtur se neni 2 i ligjit nr. 152/2013 është ndryshuar me ligjin nr. 178, datë 18.12.2014, duke iu shtuar shprehja “civilët në strukturat e FA-së”. Sipas asaj gjykate, kërkuesja, e punësuar si punonjëse civile (pedagoge e informatikës) në Komandën e FA-së, nuk përfshihej në fushën e veprimit të ligjit për nëpunësin civil.

18. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë, për sa i përket ligjit të zbatueshëm, është gjetur i drejtë nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, megjithatë, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë vetëm për sa i përket mënyrës së rivendosjes të të drejtave të kërkueses, referuar parashikimeve të KP-së. Për sa u përket pretendimeve të kërkueses për pasjen e statusit të nëpunëses civile, gjykata e apelit ka analizuar rrethanat e faktit në funksion të verifikimit nëse kërkuesja, në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, kishte fituar ose jo statusin e nëpunëses civile. Sipas gjykatës së apelit, kërkuesja ka filluar punë si punonjëse civile në strukturat e FA-së në datën 21.05.2005 dhe, pas disa transferimeve brenda këtyre strukturave, në momentin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës ushtronte detyrën si pedagoge pranë KDS-së, strukturë e FA-së. Ajo gjykatë ka vlerësuar se angazhimi i kërkueses në pozicionin e punës si pedagoge nuk rezultonte të ishte bërë në bazë të një procedure konkurrimi sipas rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 8549/1999, në fuqi në kohën e fillimit të marrëdhënies të punës, dhe as që ajo të kishte ushtruar një funksion që cilësohej si pjesë e shërbimit civil. Po sipas saj, ndonëse në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare (datë 30.09.2014) kishte hyrë në fuqi ligji nr. 152/2013 dhe VKM-ja nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, që në pikën 87 të lidhjes nr. 1 përcaktonte nëpunësit/punonjësit civilë në strukturat e FA-së, nga provat e administruara nuk rezultonte që DAP-i të kishte deklaruar statusin e saj të punësimit sipas nenit 67, pika 6, të ligjit nr. 152/2013 deri në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

19. Po ashtu, në përgjigje të pretendimit të kërkueses për fitimin e statusit të nëpunëses civile për shkak të ligjit, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se ky status nuk fitohej automatikisht me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, ndërsa ai kishte ngarkuar organet administrative kompetente me detyra dhe përgjegjësi për ngritjen e një sistemi verifikimi dhe deklarimi të statusit të nëpunësit civil për nëpunësit civilë ekzistues. Ajo gjykatë ka vlerësuar se mosmarrëveshjet për zbatimin e nenit 67, pikat 3 dhe 4, si dhe për mosnxjerrjen e një vendimi nga DAP-i në zbatim të nenit 67, pika 6, të ligjit, mund të paraqiteshin për shqyrtim

në gjykatën administrative në rast të një vendimmarrjeje ose mungese vendimmarrjeje nga njësia përgjegjëse, situatë që nuk përkonte me atë të mosmarrëveshjes objekt gjykimi. Pavarësisht se DAP-i nuk ka deklaruar statusin e punësimit të kërkueses deri më 30.09.2014, nga provat nuk rezultonte që kërkuësja të kishte kërkuar individualisht konfirmimin e statusit të saj të punësimit gjatë periudhës që ushtronte detyrën dhe që përgjigjen refuzuese ose heshtjen e DAP-it ta kishte bërë konflikt gjyqësor në përputhje me përcaktimet e nenit 67, pika 7, të ligjit nr. 152/2013.

20. Nga ana tjetër, Gjykata Administrative e Apelit ka vënë në diskutim mënyrën e rivendosjes të të drejtave të kërkueses për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës mes palëve, duke vlerësuar se ajo marrëdhënie ka qenë pa afat të caktuar dhe për ndërprerjen e saj nuk janë respektuar afatet e njoftimit sipas nenit 143 të KP-së. Po ashtu, ajo gjykatë ka konstatuar se punëdhënësi i paditur nuk ka dokumentuar zhvillimin e takimit me kërkuesen dhe se vendimi për zgjidhjen e marrëdhënies së punës ishte marrë pa respektuar kërkesat e nenit 144 të KP-së. Në konsideratë të neneve 153 dhe 154 të KP-së, gjykata e apelit ka konstatuar se zgjidhja e kontratës së punës ishte bërë për shkak të ndryshimeve strukturore të KDS-së, të cilat nuk përbënin shkak të justifikuar për përfundimin e menjëhershëm të marrëdhënies së punës, në kuptim të nenit 153, pika 2, të KP-së. Mbi këtë bazë, gjykata e apelit i ka akorduar kërkueses dëmshpërblimet sipas neneve 143, 144 dhe 155 të KP-së.

21. Gjykata e Lartë, e vënë në lëvizje me rekursat e palëve, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ajo ka vlerësuar se të dyja gjykatat e faktit me të drejtë kishin pranuar se marrëdhënia e punësimit e kërkueses nuk ishte marrëdhënie administrative e shërbimit civil dhe se kërkuësja nuk gëzonte statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 dhe, për këtë shkak, kërkimet e saj në padi nuk gëzonin mbrojtje ligjore. Nisur nga kjo, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata administrative e shkallës së parë ka përcaktuar drejt marrëdhënien juridike në konflikt, ligjin e zbatueshëm dhe, duke mbajtur në konsideratë kërkimet e padisë, shkakun dhe objektin e përcaktuar sipas ligjit nr. 152/2013, në përputhje me parimin e disponibilitetit të padisë, ka zgjidhur drejt çështjen, duke vendosur rrëzimin e padisë. Sipas Gjykatës së Lartë, në rastin objekt gjykimi gjente zbatim rregullimi i përgjithshëm ligjor i marrëdhënieve të punës, i cili nuk ishte kërkuar nga kërkuësja, dhe meqenëse ajo ka paraqitur kërkime bazuar në një shkak tjetër ligjor specifik, i cili ofronte garanci dhe ka kushte e kritere të ndryshme, se gëzonte mbrojtje si nëpunëse civile, ndonëse nuk e gëzonte këtë cilësi, Gjykata e Lartë ka çmuar se, në respekt të parimit të disponibilitetit të padisë dhe detyrimit të gjykatës për t'u shprehur vetëm për atë që kërkohet nga palët, kërkimet në padi të kërkueses nuk gëzonin mbrojtje ligjore dhe padia duhej rrëzuar.

22. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka kualifikuar drejt natyrën e mosmarrëveshjes, referuar natyrës së kërkimeve dhe arsyes së identifikuar nga kërkuesja, duke e zgjidhur gabim atë. Sipas saj, ajo për të cilën Gjykata Administrative e Apelit ishte shprehur nuk përputhej me atë që kërkuesja i ka kërkuar gjykatës me padinë e saj, duke vepruar kështu në shkelje të parimit *ultra petita partium*, pa pasur autorizim të shprehur ligjor. Sipas Gjykatës së Lartë, objekti i mosmarrëveshjes dhe kërkimet e padisë mbështeteshin në pretendimin e kërkueses se ajo gëzonte statusin e nëpunëses civile sipas ligjit nr. 152/2013, ndërkohë që Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar kryesisht objektin dhe shkakun e padisë, në shkelje të neneve 16 dhe 185 të KPC-së. Për më tepër, vetë kërkuesja, në ankimin e saj përpara Gjykatës Administrative të Apelit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke kërkuar zgjidhjen e pasojave të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në zbatim të ligjit nr. 152/2013 dhe jo sipas KP-së.

23. Për sa më sipër, referuar kërkimeve të padisë së kërkueses dhe shkakut ligjor të saj, Kolegji vëren se ajo ka pretenduar se marrëdhënia e saj e punës mbrohej nga parashikimet e ligjit për nëpunësin civil (ligjit nr. 152/2013), për sa kohë ajo ka fituar *ipso lege* statusin e nëpunëses civile, çka, sipas saj, e bënte absolutisht të pavlefshëm aktin e lirim të nxjerrë nga i padituri KDS, i cili ishte bazuar në dispozitat e KP-së. Mbi këtë shkak ligjor, gjykatat e faktit, edhe pse kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm për sa i përket zgjidhjes së pasojave të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, kanë mbajtur të njëjtin qëndrim për sa i përket ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, duke vlerësuar se ai është KP-ja dhe jo ligji nr. 152/2013, siç pretendonte kërkuesja. Ky vlerësim është i gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka prishur vendimin e gjykatës së apelit për shkakun se ajo, në lidhje me zgjidhjen e pasojave të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, nuk është shprehur në përputhje me atë që kërkuesja kishte kërkuar në padinë e saj, por përtej kërkimeve dhe shkakut ligjor të padisë, pa pasur një autorizim të shprehur ligjor.

24. Kolegji vëren se Gjykata e Lartë, në ushtrim të funksionit të saj kushtetues si gjykatë e ligjit, ka verifikuar mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta dhe ka dhënë arsyet përse kërkimet e kërkueses, të mbështetura në pretendimin për fitimin e statusit të nëpunëses civile, nuk gëzonin mbrojtje ligjore. Pavarësisht se ligji nr. 152/2013, në momentin e hyrjes në fuqi dhe kur kërkuesja vijonte të ishte në marrëdhënie pune, nuk përjashtonte nga skema e shërbimit civil punonjësit civilë të FA-së, Gjykata e Lartë ka pranuar, në thelb, qëndrimin e gjykatave të faktit se statusi i nëpunësit civil nuk fitohej automatikisht, por kërkonte një procedurë deklarimi nga DAP-i, vendimmarrja ose mosveprimi i të cilit mund t'i nënshtrohej më pas kontrollit gjyqësor. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë ka kontrolluar mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta dhe ka vlerësuar se ai është i drejtë, duke

arritur në përfundimin se kërkuesja, në kuptim të dispozitave të ligjit për statusin e nëpunësit civil (ligjit nr. 152/2013) dhe rrethanave të çështjes konkrete, nuk e kishte fituar këtë status dhe se marrëdhënia e saj e punës rregullohej nga dispozitat e KP-së. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje pretendimeve thelbësore të kërkueses në lidhje me statusin e pretenduar, ligjin e zbatueshëm dhe kufijtë e shqyrtimit gjyqësor të padisë.

24. Kolegji çmon se, në kuptim të standardeve kushtetuese të sipërcituara, nuk rezulton që arsyetimi i Gjykatës së Lartë të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm në atë masë sa të vërë në dyshim vetë thelbin e së drejtës për proces të drejtë. Vendimet gjyqësore të dhëna në çështjen e kërkueses janë arsyetuar mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese, duke u dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve thelbësore të ngritura prej saj në lidhje me statusin e nëpunësit civil, si dhe kanë përmbushur elementet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses për cenimin e procesit të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

25. Kërkuesja ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi, sipas saj, gjykatat kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm në një rast të ngjashëm, konkretisht në atë të përfunduar me vendimin nr. 00-2018-155, datë 16.01.2018 të Gjykatës së Lartë. Gjykata në jurisprudencën e saj, kur janë ngritur pretendime për cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën sesi gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, ka theksuar se vlerësimi kushtetues bëhet rast pas rasti, duke iu referuar rrethanave konkrete. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete, nuk mund të justifikojë *a priori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është atribut i çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete ka specifikat dhe individualitetin e saj, të lidhura me rrethanat, faktorët, motivet ose provat gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në vështrim të këtyre standardeve, Kolegji vëren se në rastin konkret nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë devijuar nga ndonjë vendim unifikues ose njësoes i praktikës gjyqësore. Për më tepër, referuar rastit të përmendur nga kërkuesja, Kolegji konstaton se, sikurse edhe Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar, me atë vendim Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka zgjidhur një mosmarrëveshje që kishte lindur për shkak të revokimit të vendimit të DAP-it për deklarinimin e statusit të nëpunësit civil, ndërkohë që në rastin konkret mosmarrëveshja lidhej me ndërprerjen e marrëdhënies së punës pa u deklaruar statusi i punësimit të kërkueses. Në rastin e kërkueses, sikurse gjykatat e zakonshme kanë pranuar, asaj nuk i ishte njohur statusi i nëpunësit civil nga DAP-i. Pikërisht mbi këtë dallim gjykatat e zakonshme kanë mbajtur qëndrimin se kërkuesja duhej të kishte kërkuar njohjen e

këtij statusi, duke iu drejtuar DAP-it me kërkesë dhe se vendimmarrja ose mungesa e vendimmarrjes së këtij institucioni mund t'i nënshtrohej më pas kontrollit gjyqësor. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se edhe ky pretendim i kërkueses është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.